



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.191/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Ferizaj për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 400(katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 11.10.2017, me të cilën pretendon se në rrugën “Driton Islami” dhe rrugën “Idriz Islami” në Ferizaj, anëtarët e subjektit politik LDK kanë vendosur flamuj dhe simbole të subjektit të tyre në shtylla elektrike. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë kandidati për kryetar të Komunës së Ferizajt Muharrem Sfarça, nga radhët e subjektit politik LDK, ka shkelur nenin 33.1 pika b e LZP-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi dëshmi.

Në përgjigjen në ankesë Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 13.10.2017, konsiderojnë se ankesa është e pabazuar për shkak se vendosja e materialit zgjedhor në shtyllë elektrike është në një lartësi të zakonshme për vendosjen e tyre dhe nuk do të duhej të përbënte veprim të ndaluar.

Subjekti politik LDK kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë nga BIRN të hidhet poshtë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Muharrem Sfarça, kandidat për Kryetar të Komunës së Ferizajt, nga radhët e subjektit politik LDK, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana*

e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtat janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen edhe pse kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, paneli vlerësoi se gjoba e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr. 191/2017 më datën 16.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.